



## REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVO

AC.nr.984/20

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin gjyqësor të përbërë nga gjyqtarët: Burim Shala kryetar i kolegjit, Nehat Idrizi dhe Hunaida Pasuli , anëtarë të kolegjit në çështjen juridike të paditëses L.K nga Prishtina, të cilën me autorizim e përfaqëson N.H avokat në Prishtinë, kundër të paditurave Republika e Kosovës - Qeveria e Republikës së Kosovës-Ministra e Punëve të Brendshme me seli në Prishtinë të cilën e përfaqëson avokatura shtetërore, N.N.T “A.....”, me seli në Istog të cilën me autorizim e përfaqëson N.G avokat nga Lipjani, për kompensimin e dëmit, duke vendosur sipas ankesës së paditëses dhe të paditurave, të paraqitura kundër aktgjyqimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, C.nr.373/19, të datës 15.07.2019, në seancën e kolegjit të mbajtur , me datë 10.05.2023 mori këtë :

### A K T G J Y K I M

REFUZOHEN të pathemelta ankesat e paditëses L.K nga Prishtina dhe të paditurave Republika e Kosovës - Qeveria e Republikës së Kosovës-Ministra e Punëve të Brendshme me seli në Prishtinë, dhe N.N.T “A...”, me seli në Istog ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, C.nr.373/2019 i datës 15.07.2019, VËRTETOHET.

### A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prishtinë, me aktgjykimin C.nr.373/2019 i datës 15.07.2019, ka vendosur si vijon : Aprovohet pjesërisht si të bazuar kërkesëpadinë e paditëses L.K nga Prishtina dhe i ka detyruar të paditurat që paditëses në mënyrë solidare të ia kompensojnë dëmin jo materiale dhe material, dhe ti paguajnë në emër të dëmit jo material për dhimbje fizike shumë prej 4000 euro, për frikën e përjetuar shumë prej 3000 euro, për zvogëlim të aktivitetit jetësor shumë prej 20000 euro, për shëmtim shumë prej 3000 euro. Në emër të dëmit material për ndihmë dhe kujdes të huaj shumë prej 280 euro, ushqim të përforcuar shumë 420 euro për zvogëlim të aftësisë punuese-rentës për periudhën e kaluar nga dita e aksidentit dt.01.12.2009 e deri më dt.31.08.2018, shumë prej 12,476,55 euro. Për periudhën e ardhshme prej datës 01.08.2018, e deri sa të ekzistojnë kushtet ligjore në shumë 132,18 euro. Refuzohet pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditëses me të cilën ka kërkuar që të detyrohen të paditurat që në emër të dhimbjeve fizike të ia paguaj shumë edhe prej 6000 euro, për frikën e përjetuar shumë prej 5000 euro, për zvogëlim të aktivitetit jetësor shumë prej 15.000 euro, për shëmtim trupor shumë prej 1000 euro, në emër të dëmit material për rehabilitim shumë prej 364 euro.

Kundër këtij aktgjykimi, paditësja në afatin ligjor përmes të autorizuarit të saj për pjesën refuzues të kërkesëpadisë ka paraqitur ankesë për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që ankesa të miratohet e bazuar të ndryshohet aktgjykimi i ankimuar dhe të aprovohet në tërësi kërkesëpadia e paditëses e bazuar.

Ankesë kundër aktgjykimit të lartë përmendur kanë paraqitur edhe të paditurat për shkak të shkeljes thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që ankesat të aprovohen të bazuara dhe aktgjykimi i ankimuar të priset dhe çështja të kthehet në rivendosje.

Gjykata e Apelit në seancën e kolegjit, në kuptim të nenit 194 të LPK, ekzaminojë aktgjykimin e shkallës së parë brenda kufijve dhe shkaqeve të treguara në ankesa dhe duke u kujdesur sipas detyrës zyrtare për zbatimin e së drejtës materiale si dhe për shkeljen e dispozitave të procedurës kontestimore dhe gjeti se:

Ankesat janë të pa themelta

Nga shkresat e lëndës, rrjedh se paditësja , me datën 13.04.2010 ka paraqitur padi për kompensim dëmi material dhe jo material, kundër të paditurave.

Gjykata e shkallës së parë, duke vepruar sipas padisë së paditëses, në procedurën e provave ka administruar provat, si: raportin policor, aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Prishtinë, aktgjykimin e Gjykatës së Apelit PAI.nr.3426, ekspertizën e mbrojtjes dhe sigurisë në punë, ekspertizën e mbrojtjes dhe sigurisë në punë e punuar nga tre ekspertë gjyqësor, ekspertizat mjekësore, ekspertiza e aktuaristikës dhe pas vlerësimit të tyre ka konstatuar gjendjen faktike prej nga ka gjetur se kërkesëpadia e paditëses është e bazuar pjesërisht.

Në arsyetim të aktgjykimit gjykata e shkallës së parë ka theksuar se nuk ishte kontestues fakti se ka ndodhur aksidenti në rrugën F.G, në afërsi të OSB-së, se ka pas erë të fortë atë ditë, e po ashtu se paditësja derisa ishte duke ecur në trotuar i ka rënë në kokë rrethoja e cila ishte vendosur për rrethimin e objektit. Kontestues ishte fakti se nëse të paditurat janë përgjegjëse ose jo për shkaktimin e incidentit, kontestuese po ashtu ishte se cila prej të paditurave duhet ta shpërblej dëmin. Nga ekspertiza e punuar prej tre ekspertëve të lëmisë së mbrojtjes dhe sigurisë në punë Prof.dr. B.B, Prof.dr. A.K dhe Msc H.H është konstatuar fakti se deri te aksidenti ka ardhur për shkak se paditësja duke kaluar në trotuar është goditur në kokë nga dera prej llamarinës e rrethojës së vend punishtës të objektit QRA-së, deri te kjo ka ardhur si rezultat se pune kryesi nuk e ka përforcuar mirë dhe në mënyrë të duhur këtë derë prej llamarine. Kryesi i punëve është dashur ta dijë se për shkak të sezonit është dashur të marr masa më të shtuara për të siguruar një ambient të sigurt, prandaj përgjegjësia për kompensimin e dëmit bie mbi palët e paditura, ndërsa pala paditëse sipas grupit të ekspertëve nuk ka kurrfarë përgjegjësie.

Gjykata e shkallës së parë, lidhur me lartësinë e kërkesëpadisë është mbështetur në mendimin e ekspertëve mjekësor, prej nga e ka aprovuar pjesërisht kërkesëpadinë e paditëses.

Gjykata e Apelit, nisur nga kjo gjendje e çështjes pajtohet me pikëpamjet juridike të gjykatës së shkallës së parë pasi që përfundimi i saj është i rregullt dhe i ligjshëm për arsye se aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) e LPK-së dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së, por as me shkelje të cilat pretendohen me ankesë nga të paditurat.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, nuk qëndron pretendimi ankimor, i të paditurave se aktgjykimi i ankimuar është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës

kontestimore nga neni 182 parag.2, pika n). Aktgjykimi nuk është i përfshirë në të meta për shkak të cilave nuk mund të ekzaminohet dhe në lidhshmëri me këtë dispozitivi i aktgjykimit është i qartë, i kuptueshëm dhe i përmbarueshëm. Gjykata e shkallës së parë ka dhënë arsye të mjaftuara për faktet vendimtare të cilat janë konstatuar te kjo çështje juridike si dhe për provat me të cilat i ka konstatuar këto fakte duke dhënë vlerësimet e nevojshme dhe të mjaftuara për besueshmërinë e provave.

Drejtë është konstatuar se incidenti i ndodhur më datë 01.12.2009, ka ndodhur me fajin dhe përgjegjësinë e të paditurave, dhe se paditësja si kalimtare e rastit në trotuar nuk ka kurrfarë përgjegjësie apo kontributi. Kjo është konstatuar, nga ekspertiza e grupit të ekspertëve të mbrojtjes dhe sigurisë në punë. Prandaj gjykata e shkallës së dytë i vlerëson si të pa qëndrueshme pretendimet ankimore sidomos të paditurës së dytë në këtë drejtim dhe e merr si të vërtetuar faktin vendimtar i cili ngitet me ankesë se ditën kritike, ka pasur erë mirëpo e paditura e dytë është dashur ta përforcoj më shumë derën e llamarinës së vend punishtes, në mënyrë që të mos shkaktoj dëm personave që kalojnë përreth saj, pavarësisht shkaqeve natyrore përkatësisht erës.

Grupi ekspertëve nga mbrojtja dhe siguria në punë ka bërë vlerësimin se përgjegjës për dëmin e shkaktuar janë të paditurat pasi nuk kanë ndërmarr veprimet e nevojshme për të siguruar një mjedise të sigurt të vend punishtes në raport edhe me personat e tretë që kalojnë afër vend punishtes.

Është i pa qëndrueshëm pretendimi ankimor i paditurës së parë Qeverisë së Kosovës – MPB-së, ajo ka përgjegjësi solidare për shpërblimin e dëmit, pasi ka nënshkruar kontratën për ndërtim me të paditurën e dytë për kryerjen e punëve publike, dhe mbi këtë bazë ajo është dashur ta mbikëqyre punën e të paditurës së parë, edhe ajo ka përgjegjësi solidare, ajo ka të drejtë që përmes regresit të kërkoj prej kompanisë fituese pagimin e shumës së kompensuar për shkak të mos përmbushjes së kontratës gjegjësisht mos sigurimit të vend punishtes, në rast se vlerëson se nuk ka përgjegjësi për shpërblimin eventual të dëmit paditëses. Kjo është paraparë shprehimisht me dispozitën e nenit 207 të LMD-së ku është përcaktuar se porositësi i punëve dhe zbatuesi i punimeve përgjigjen solidarisht ndaj personit të tretë për dëmin e shkaktuar atij. Pra e paditura e parë është porositësi i punimeve, ndërsa e paditura e dytë zbatuesi i punimeve të projektit në fjalë, ku ka ndodhur incidenti, prandaj në kuptim të dispozitës së lartë cekur mbajnë përgjegjësi solidarisht.

Gjykata e Apelit bazuar në gjendjen e fakteve dhe nga provat e nxjerra gjatë gjykimit në shkallë të parë vlerëson se baza juridike e kërkesëpadisë së paditëses është konstatuar mjaftueshëm dhe se përgjegjësia e dy të paditurave për kompensimin e dëmit paditësit rrjedh nga detyrimi i tyre për të siguruar një ambient të sigurve të punës.

Me dispozitën e nenit 178 al.2 të LMD-së shprehimisht është paraparë se “ në qoftë se ekziston faji dy palësh secili zotërues përgjigjet për dëmin total që e kanë pësuar ata përpjesëtimisht me shkallën e fajësisë së tyre së tyre”. Ndërsa me dispozitën e nenit 206 al.3 të LMD-së është paraparë se “ përgjigjen solidarisht për kompensimin e dëmit edhe personat që e kanë shkaktuar dëmin duke punuar pavarësisht njëri tjetrit në qoftë se nuk mund të vërtetohet kontributi i tyre në dëmin e shkaktuar. Me dispozitën e nenit 154 të LMD-së është paraparë shprehimisht se kush tjetrit i shkakton dëm e ka për detyrë ta kompensoj, në qoftëse nuk provon se dëmi ka lindur pa fajin e tij. Me dispozitën e nenit 172 të LMD-së është paraparë shprehimisht se personi juridik përgjigjet për dëmin të cilin organi i tij ia shkakton personit të tretë gjatë ushtrimit ose lidhur me ushtrimin e funksioneve të tij.

Gjykata e Apelit , i vlerëson të pa bazuara pretendimet ankimore të paditëses dhe të paditurave vlerëson se në kuptim të dispozitave materialo-juridike të cilave u është referuar gjykata e shkallës së parë e në përputhje me gjendjen faktike, natyrën e rëndë të lëndimit ( 35 % zvogëlimi i aktivitetit të përgjithshëm jetësor ) , moshën e saj të re dhe rrethanat tjera që ndikojnë në përcaktimin e lartësisë së kompensimit siç janë lloji dhe kohëzgjatja e dhimbjeve fizike, lloji, intensiteti dhe kohëzgjatja e frikës, zvogëlimi i aktivitetit të përgjithshëm jetësor, shkallën e shëmtimit si dhe rrethanat tjera, si : moshë e paditësit dhe praktika gjyqësore të cilat rezultojnë se shumata e gjykuara janë në përputhje me qëllimin e kompensimit. Gjykata ka vendosur në mënyrë të ekuilibruar në mes të shumave të gjykuara dhe natyrës së lëndimeve përkatësisht dëmeve që ka pësuar paditësja, duke siguruar që kompensimi i gjykuar të jetë satisfaksion për paditësen, duke shmangur qëllimet tjera materiale (lukrative) që mund të bien ndesh me qëllimin e satisfaksionit në raste të tilla.

Me dispozitën nenit 200 të LMD-së po ashtu shprehimisht parashihet se “ për dhimbjet e pësuar fizike për dhimbjet e pësuar shpirtërore si rezultat i zvogëlimit të aktivitetit të jetesës, të prishjes dhe shkeljes së nderit ose lirisë, të vdekjes së personit të afërm si dhe për frikën gjykata po të konstatoj se rrethanat e rastit sidomos intensitetit të dhimbjeve, dhe frikës dhe zgjatjes së tyre e justifikon këtë do të gjykoj kompensimin e drejtë në të holla pavarësisht nga kompensimi i dëmit

material si dhe mungesa e tij. Me rastin e vendosjes për kërkesën mbi kompensimin e dëmit jo material si dhe mbi shumën e kompensimit gjykata do të merr parasysh rendësin e shkeljes së të mirës dhe qëllimit të cilit i shërben ky lloj kompensimi ashtu që ai të mos iu shkoj për shtati synimeve që nuk janë të pajtueshme me natyrën e saj dhe me qëllimin shoqëror.

Nga arsyet e cekura më lartë, Gjykata e Apelit në bazë të nenit nenin 194 dhe 195 par. 1 pika d), të LPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

## GJYKATA E APELIT E KOSOVËS - PRISHTINË

AC.nr.984/20 me datë 10.05.2023

Kryetar i kolegjit,

Burim Shala d.v.